VENDIM
Nr.5, datë 16.2.2006

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1, DATË 11.1.2006 PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA "KORSEL" SHPK TE SHOQËRIA "MAKSI ELEKTRIK" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.1, datë 11.01.2006 "Për transferimin e licencës nga shoqëria "Korsel" sh.p.k. te shoqëria "Maksi Elektrik" sh.p.k., Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2006, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Departamenti i Licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, mbi transferimin e licencës nga shoqëria "Korsel" sh.p.k. te shoqëria "Maksi Elektrik" sh.p.k. për hidrocentralet Leskovik 1 dhe 2 të Rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.1, datë 11.01.2006 "Për transferimin e licencës nga shoqëria "Korsel" sh.p.k. te shoqëria "Maksi Elektrik" sh.p.k." në fund të fjalisë të shtohet shprehja:

- me një afat 28-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema